

VENDIM
Nr.346, datë 29.4.2020

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E DREJTËSISË TEK AGJENCIA SHETETËRORE E KADASTRËS, PËR PRONAT E PËRCAKTUARA NË VENDIMIN NR.411, DATË 29.8.2002, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN E DISA MJEDISEVE NË ADMINISTRIMIN E ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE TË ZYRAVE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË, KORÇË DHE DURRËS”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, 13, 14 dhe 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 6 e 7, të ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Zëvendëkryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Drejtësisë tek Agjencia Shtetërore e Kadastrës, për pronat e përcaktuara në vendimin nr.411, datë 29.8.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e disa mjediseve në administrimin e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë, Korçë dhe Durrës”, të ndryshuar.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama